

UDHËZIM
Nr.2, datë 28.1.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për TVSH-në” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Në pikën 1.1, b) paragrafi i dytë riformulohet si më poshtë:

“Tatimpaguesit importues, që kanë vendndodhje të biznesit në Malësinë e Madhe, Sarandë, si dhe që realizojnë një qarkullim më të vogël se 5 milionë lekë në çdo vit kalendarik.”.

Pikën 8.1.1 “Vlera minimale e tatueshme e ndërtimit të banesave” ndryshohet si më poshtë:

Në bazë të nenit 27/1 të ligjit, vlera minimale e tatueshme në procesin e ndërtimit të banesave, bazohet në çmimin minimal fiskal dhe sipërfaqen e ndërtimit.

Çmimi orientues minimal fiskal, për procesin e ndërtimit të banesave, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, pas këshillimit me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë.

Përcaktimi i kostos reale për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në sektorin e ndërtimit, të investimeve private apo publike, do të përcaktohet në bazë të metodologjisë së dhënë në vendimin e Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit”. Metodologjitë e llogaritjes së kostos minimale fiskale, çmimit dhe fitimit minimal fiskal për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në sektorin e ndërtimit, të investimeve private apo publike, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, do të shërbejnë si metodologji alternative të vlerësimit të parë.

Në pikën 8.1.2. “Mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim” germa (b) ndryshon si më poshtë:

b) Kur shoqëritë e ndërtimit të licencuara profesionalisht, do të ndërtojnë objekte për qëllim përdorimi në funksion të aktivitetit të tyre të tatueshëm (jo për furnizime të përjashtuara) kemi të bëjmë me vetëfurnizim të ndërtesave. Për çdo muaj, shoqëria ndërtuese përpilon situacionin e punimeve të kryera. Bashkëngjitur çdo situacioni mujor, do të jetë detyrimisht edhe fatura tatimore. Personi i tatueshëm është i detyruar të llogarisë TVSH-në çdo muaj kalendarik. Fatura tatimore e përpiluar si më sipër, regjistrohet njëkohësisht në librin e blerjeve dhe të shitjeve të shoqërisë.

Lejohet kreditimi i TVSH-së së paguar në blerjet e bëra për këtë qëllim. Kreditimi lejohet i plotë për rastet kur personi i tatueshëm kryen aktivitet ekonomik plotësisht të tatueshëm, si dhe i pjesshëm kur kryhen aktivitet pjesërisht të tatueshëm. Është kusht që ndërtesat e kësaj natyre duhet të jenë të destinuara për kryerjen e aktiviteteve të tatueshme nga vetë shoqëria. Gjithashtu ndërtesat duhet të jenë të një tipi të tillë, që natyra dhe qëllimi i përdorimit të tyre të shpallen dhe aprovohen në lejen e ndërtimit të dhënë nga organet e qeverisjes vendore.

Pika 8.1.3 riformulohet sa më poshtë:

8.1.3 “Furnizimi i dhënies me qira të ndërtesave”.

“Pavarësisht nga përjashtimet e parashikuara në nenin 20 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, personi i tatueshëm gëzon të drejtën që në bazë të kërkesës së tij pranë organit tatimor, dhënia me qira e ndërtesave që ai furnizon, sipas pikës 3 të këtij neni, të mos e trajtojë si furnizim i përjashtuar, por ta konsiderojë furnizim i tatueshëm, sipas nenit 16 të ligjit “Për TVSH-në”. Në këto raste, subjekti furnizues depoziton një kërkesë me shkrim pranë drejtorisë trajonale tatimore ku deklaron se qiradhënia do të trajtohet si furnizim i tatueshëm, duke deklaruar edhe të dhënat e subjektit qiramarrës (emri, NIPT, adresa etj.).

Në rast se qiradhënësi kryen furnizim qiradhënie për subjekte të cilat ushtrojnë aktivitet të përjashtuar me ligj nga TVSH-ja (të tilla, si aktivitete lojëra fati, shërbim financiar etj.) qiradhënia trajtohet si furnizim i tatueshëm, vetëm në rast se në kontratën e qiradhënies, palët kanë rënë dakord se qiradhënien do ta trajtojnë si furnizim të tatueshëm me TVSH. Në këto raste, tatimpaguesi qiradhënës

duhet të depozitohet, përveç kërkesës me shkrim pranë organit tatimor edhe kontratën e qirasë. Mungesa e kontratës, nuk i jep të drejtën e trajtimit të qiradhënies si furnizim i tatueshëm.

Pika 8.4 “Shërbimet postare” ndryshohet si më poshtë

Shërbimi i furnizimit të pullave të postës për përdorim për shërbime postare dhe pullave të tjera të ngjashme, përjashtohen nga TVSH-ja. Por, në qoftë se posta bën importe apo kryen edhe shërbime të tjera postare, dhe qarkullimi vjetor kalendarik i saj është më i madh se 5 milionë lekë, ajo duhet të regjistrohet dhe të paguajë TVSH-në.

Pika 9.5.3. “Rregulla të përgjithshme” riformulohet si më poshtë:

9.5.3. Rregulla të përgjithshme

a) Furnizuesit kryesorë, në varësi të marrëdhënieve që vendosin me furnizuesit e ndërmjetëm të tyre, zgjedhin njërin nga dy mënyrat e mësipërme të faturimit, të përcaktuara në pikat 9.5.1 ose 9.5.2 më lart, por jo të dy mënyrat njëkohësisht.

b) Çmimi maksimal i shitjes me pakicë të cigareve, për çdo lloj cigareje dhe çdo lloj pakete, përcaktohet nga furnizuesit kryesorë.

c) Furnizuesit kryesorë janë të detyruar të deklarojnë çmimin maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj pakete dhe çdo lloj cigareje. Deklarata e ndryshimit të çmimit të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete, duhet të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar furnizuesi kryesor, jo më vonë se 10 ditë para datës së aplikimit të çmimit të ri maksimal të shitjes me pakicë.

ç) Furnizuesit kryesorë janë të detyruar të publikojnë deklaratën e ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete në jo më pak se dy gazeta ditore nacionale dhe jo më vonë se 5 ditë nga data e aplikimit të çmimit të ri. Për efekte marketingu çmimet maksimale mund të vazhdojnë të publikohen në çdo media të shkruar apo elektronike për aq kohë sa ato çmime janë në fuqi.

d) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është e detyruar të publikojë në faqen e saj të internetit çmimet e reja maksimale të shitjes me pakicë të cigareve jo më vonë se dy ditë para datës së zbatimit të çmimeve të reja. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të publikojë çmimet maksimale të shitjes me pakicë të cigareve në çdo formë tjetër publikimi.

dh) Ndalohet shitja e cigareve me çmim më të lartë se çmimi maksimal i shitjes me pakicë, i deklaruar sipas pikave a-d më lart. Drejtoritë Rajonale Tatimore kontrollojnë zbatimin e çmimeve maksimale të shitjes me pakicë të cigareve. Shitja e një pakete cigare me çmim më të lartë se çmimi i deklaruar, konsiderohet shkelje.

e) Tatimpaguesit që kanë gjendje malli në magazinë deri në hyrjen në fuqi të skemës, e faturojnë atë për furnizuesin e tyre, me çmimin e blerjes. Furnizuesi kryesor e rifaturon këtë sasi ndaj furnizuesve të tjerë, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë udhëzim. Njësitë e shitjes me pakicë, jo subjekte të TVSH-së, nuk kanë detyrim të faturojnë për furnizuesit e tyre. Gjithë ky proces vazhdon deri sa faturimi përfundon tek furnizuesi kryesor.

Pas pikës 13.4 shtohet pika 13.5 me këtë përmbajtje:

Subjektet e regjistruara pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj duhet të dorëzojnë elektronikisht një kopje të regjistrimeve mujore në librin e blerjeve dhe të shitjeve të muajit janar 2010 brenda datës 14 shkurt 2010. Për periudhat e tjera, dorëzimi në mënyrë elektronike i librit të blerjes dhe shitjes do të bëhet brenda datës 5 të çdo muaji. Këto dokumente tatimore do të ngarkohen dhe dërgohen elektronikisht në adresë të organeve tatimore.

Për subjektet e regjistruara për TVSH-në, si dhe subjektet e regjistruara pranë Drejtorisë Rajonale të Rretheve, një kopje e regjistrimeve mujore të tatimpaguesit në librin e blerjeve dhe të shitjeve, do të ngarkohen dhe dërgohen elektronikisht brenda datës 5 të çdo muaji në adresë të organeve tatimore, duke filluar nga afatet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Formati elektronik i librave të blerjes dhe shitjes, dhe formulari i deklarimit dhe pagesës së TVSH-së është sipas tabelave bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Në pikën 19.4/1, në nënndarjen e dytë, pas fjalisë “Në këtë rast TVSH e paguar për blerje kreditohet menjëherë, me kushtin që ai të përdoret vetëm për nevoja të veprimtarisë ekonomike të tatueshme dhe për asnjë nevojë tjetër.” shtohet fjalia “Për veprimtaritë e mëposhtme të listuara sipas kategorive do të lejohet kreditimi i TVSH-së në blerje të gazoilit deri në normativat e përcaktuara në pikën 19.5 të këtij udhëzimi”.

Pas pikës 19.4 të udhëzimit për TVSH-në, shtohet pika 19.5 me këtë përmbajtje:

Pika 19.5 “Raste të veçanta për trajtimin e së drejtës për kreditimin e TVSH-së”.

Kreditimi i TVSH-së në blerje të gazoilit të kryera për qëllime të veprimtarive ekonomike të ndërtimit, transportit dhe tregtisë të kategorizuara si më poshtë është i lejueshëm deri në normativat e përcaktuara mbi bazën e treguesit të përcaktuar sipas peshës specifike që blerjet për gazoil zënë, në raport me qarkullimin e kryer për qëllime të aktivitetit. (Qarkullimi është përkufizuar në udhëzimin e Ministrit të Financave “Për TVSH”)

NORMATIVAT E HARXHIMIT TË KARBURANTIT

I. NDËRTIM

a. Prodhim materiale inerte	deri më	25%
b. Ndërtim shtrim rrugesh	deri më	20%
c. Ndërtim banesash dhe objekteve të ndryshme	deri më	6%
d. Prodhim betoni	deri më	14 %

II. TRANSPORT

a. Transport udhëtarësh	deri më	18 %
b. Transport mallrash	deri më	15%

III. TREGTI deri më 3%

IV: PËR TË GJITHA AKTIVITETET E TJERA JO TË LISTUARA NË KËTË PIKË deri në 2%

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Libri i Blerjeve													
Shoqeria		Emri i Shoqerise											
Nipti		Nipti i Shoqerise											
Viti		Viti per te cilin plotesohet libri (yyyy)											
Muaji		Muaji per te cilin plotesohet libri - muaji nga 01 deri 12											
Pa veprimtari		Ploteso PO nese gjate muajit nuk eshte bere asnje transakcion.											
Fatura			Shitesi			Totali Blerjeve (perfshire TVSH)		Blerjet					
Nr Fatures	Numri Serial	Data (dd/mm/yyyy)	Emri tregtar / personi	Rrethi	NIPT	/Kodi Fermerit	Te perjashtuara,me Tvsh jo te zbritshme dhe pa TVSH	Importe		Nga Furnitore Vendas		Nga Fermeret vendas	
								Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh
a	b	c	d	e	f	g=(h+i+j+k+l+m+n)	h	i	j	k	l	m	n
Shuma totale													
Kutia sipas Formularit te Deklarimit dhe Pageses se TVSH-se							kutia (13)	kutia (14)	kutia (15)	kutia (16)	kutia (17)	kutia (18)	kutia (19)
Shpjegim:													
Ne rastin kur ky liber do te printohet, per qellime te ruajtjes/ mbajtjes se dokumentacionit, cdo faqe e printuar duhet te kete ne krye permbajtjen / rreshtat nga 1 ne 12.													
Nr i rreshtave mund te shtohet ne perputhje me nr e transakcioneve													

Libri i Shitjeve

Shoqeria		Emri i Shoqerise								
Nipti		Nipti i Shoqerise								
Viti		Viti per te cilin plotesohet libri (yyyy)								
Muaji		Muaji per te cilin plotesohet libri - muaji nga 01 deri 12								
Pa veprimtari		Ploteso PO nese gjate muajit nuk eshte bere asnje transakcion.								
Fatura			Bleresi			Totali Shitjeve	Shitjet e perjashtuara	Eksporte /Furnizime me 0%	Shitje	
Nr Fatures	Numri Serial	Data (dd/mm/yyyy)	Emri tregtar /personi	Rrethi	NIPT				Vlera e Tatueshme	Tvsh
a	b	c	d	e	f	$g = (h+i+j+k)$	h	i	j	k
Shuma totale										
Kutia sipas Formularit te Deklarimit dhe Pageses se TVSH-se							kutia (9)	kutia (10)	kutia (11)	kutia (12)
Shpjegim:										
Ne rastin kur ky liber do te printohet, per qellime te ruajtjes/ mbajtjes se dokumentacionit, cdo faqe e printuar duhet te kete ne krye permbajtjen / rreshtat nga 1 ne 12.										
Nr i rreshtave mund te shtohet ne perputhje me nr e transakcioneve										

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESES SE TVSH



Numri i Vendosijes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial:

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):

(3)

Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:

(4)

Emri Mbiemri i Personit Fizik:

(5)

Adresa:

(6)

Qyteti/Komuna/Rrethi:

Numri Telefonit:

(7)

Lajmeroni nese informacioni i mesiperm eshte jo i plote ose ka ndryshuar

☐ [8] Shenoni 'X' nqs gjate muajit nuk eshte bere asnje transakcion.Vendosni Daten,Firmosni dhe dorezoni Deklaraten.

TVSH e llogaritur për muajin

(9) Shitje të përjashtuara

(10) Eksporte/Furnizime me shkalle 0%

(11) Shitjet e tatueshme

TVSH e paguar për muajin

(13)Blerjetë përjashtuara,TVSH jo të zbritshme,pa tvsh

(14) Importe

(16) Blerje nga furnitore vendas

(18) Blerje nga fermeret vendas

Saktësime

(20) TVSH i zbritshëm,mbartur nga muaji kaluar

(21)Kërkesë rimbursimi i tepicës së TVSH së zbritshme nga muaji kaluar

(22)Gjendja TVSH së zbritshme nga muaji kaluar{(20)-(21)}

(23) Totali i TVSH së zbritshme për muajin {(15)+(17)+(19)+(22)}

(24)Teprica eTVSH të zbritshëm {(23)-(12)nqs(23)>(12)}
(Të mbartet në muajin pasardhës)

(25) TVSH I DETYRUESHEM PER TU PAGUAR {(12)-(23)nqs(12)>(23)}

(26) Gjoha për vonesa në Pagesë/Dorëzim deklarate

(27) TOTALI PER TU PAGUAR

Vlera e tatueshme

TVSH i llogaritur

(9)	
(10)	
(11)	(12)

Vlera e tatueshme

TVSH i zbritshëm

(13)	
(14)	(15)
(16)	(17)
(18)	(19)

(20)	
(21)	
	(22)
	(23)
(24)	
	(25)
	(26)
	(27)

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem - Deklaroj nen pergjegjesine time qe informacioni i mesiperm eshte i plote dhe i sakte.

PAGESA

Vetem per perdorim zyrtar

☐ Leke

☐ Xhirim

☐ Cek

☐ Te tjera:.....

(28)SHUMA E PAGUAR:

(28)

Data , Vula e Bankes dhe nenshkrimi i nepunesit te bankes

Origjinali - Drejtoria Rajonale Tatimore
Kopja -Personi i Tatueshem

Periudha e deklaruar

1. Numri serial perdoret nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe sherben per te azhomuar regjistrimet tuaja kur paraqitet deklarata
2. Periudha Tatimore eshte muaji i paraqitur nga dita e pare deri ne ditën e fundit. Te gjitha transakcionet (Shitjet, Blerjet dhe kesatesimet) te kryera gjate kesaj periudhe duhet te pershihen ne kete deklarate.

Hollesi te Personit te Tatueshem.

3. Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT) eshte numri i vetem qe ju perfaqeson ju ne te gjitha marrëdhëniet me Drejtorine Rajonale Tatimore. Ju duhet ta vendosni NIPT-in tuaj ne te gjitha faturat.

4. Emri Tregtar i Personit te Tatueshem eshte emri me te cilin ju paraqitni veprimtarine tuaj dhe qe tregohet ne certifikaten tuaj te NIPT-it

5. Emri, Mbiemri i Personit Fizik vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga nje Person Fizik dhe nuk ka emer tregtar

6. Adresa tregohet per vendin kryesor te ushtrimit te veprimtarise tuaj ekonomike. Kjo adrese eshte e treguar edhe ne certifikaten tuaj te NIPT-it

7. Numri i Telefonit (nqs keni) tregon numrin e telefonit ne vendin kryesor te ushtrimit te veprimtarise tuaj ekonomike.

Shenim: Nqs ndonje nga treguesit e rubrikave 4, 5, 6, 7 ka ndryshuar, lutemi paraqitni informacionin e ri.

Mungese veprimtarie per muajin.

8. Nqs ju nuk keni kryer asnje tip transakcioni gjate muajit, shënoni një "X" ne kutinë 8. Asnje informacion shtesë nuk ju kërkohet vese t'i vendosni datën deklarates, ta firmosni atë, ta paraqitni në bankë sic veproni me pagesat normale te TVSH.

Shitjet tuaja (Qarkullimi) për muajin

9. Nga kolona "Shitje të përjashtuara" e Librit tuaj të Shitjeve, nxirri totalin e të gjithë shitjeve të përjashtuara të muajit dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale i shitjeve të përjashtuara në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 9 të Deklaratës tuaj. Shitjet e Përjashtuara nuk i nënshtrohen TVSH.

10. Nga kolona "Eksporte/Furnizime me 0%" e Librit tuaj të Shitjeve, nxirri totalin e të gjithë eksporteve apo furnizimeve me shkallë tatimore 0% të bëra për muajin dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale, në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 10 të Deklaratës tuaj. Eksportet taten me 0%.

11. Nga kolona "Vlera e Tatueshme" e Librit tuaj të Shitjeve, nxirri totalin e të gjitha shitjeve të bëra gjatë muajit dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale i vlerës së tatueshme në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 11 të Deklaratës tuaj. Shitjet e Tatueshme i nënshtrohen një tatimi prej 20%.

12. Nga kolona 12 "Shitjet e Tatueshme-TVSH", e Librit tuaj të Shitjeve, nxirri totalin e këtyre shitjeve për muajin dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale tvsh e shitjeve të tatueshme në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 12 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 12 duhet të paraqesë 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 11.

Blerjet tuaja gjatë Muajit.

13. Nga kolona 13 "Blerje të përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh" e Librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale i blerjeve të përjashtuara, me tvsh jo të zbritshme dhe pa tvsh në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 13 të Deklaratës tuaj. Për këto blerje nuk do të bëhet zbritje e TVSH. Këtu do të regjistrohen dhe blerjet pa tvsh.

14. Nga kolona "Vlera e Tatueshme e Importeve" e Librit tuaj të Blerjeve për muajin, mbliidni totalin e këtyre blerjeve dhe shkruani rezultatin në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 14 të Deklaratës tuaj. TVSH e paguar në import zbritet.

15. Nga kolona "Importe TVSH" e Librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale i importeve tvsh në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 15 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 15 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 14.

Plotësoni Deklaratën dhe Paguani TVSH

Deklarata duhet të plotësohet dhe paraqitet nga ju në bankë për pagesë Brenda datës 14 të muajit pasardhës nga muaji i treguar ne Deklaratë si periudhë tatimore. Nqs ju keni pagesë për të bërë dhe e bëni këtë pagesë Brenda kësaj date shënoni shumën e kutisë 25 në kutinë 27. Nqs bëhet një pagesë e pjeseshme ose një pagesë e vonuar, detyrimit tuaj i shtohen gjoa dhe interese. Drejtoria Rajonale Tatimore mund t'ju tregojë vlerën që duhet të vendosni në kutinë 26. Mbliidni vlerën e kutisë 25 me atë të kutisë 26 dhe shënoni detyrimin total në kutinë 27. Vendosni datën e plotësimit të Deklaratës, firmosni atë dhe paraqitni në bankë, ku një kopje e kësaj deklarate do t'ju kthehet pas pagesës. Ju duhet të paraqitni në bankë me këtë deklarate edhe nqs nuk keni ndonjë shumë për të paguar.

Për më shumë informacion lexoni Udhëzuesin e TVSH ose merrni kontakt me Drejtorine Rajonale Tatimore ku jeni i regjistruar.

16. Nga kolona "Vlera e tatueshme e blerjeve brenda vendit" e Librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale i vlerës së tatueshme në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 16 të Deklaratës tuaj. Për mallrat e blera nga furnizues vendas që janë regjistruar për TVSH, përfitohet zbritja e TVSH.

17. Nga kolona "TVSH blerje brenda vendit" e Librit tuaj të Blerjeve, mbliidni totalin e këtyre blerjeve dhe paraqitni rezultatin në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 17 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 17 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 16.

18. Nga kolona "Vlera e tatueshme e blerjeve nga fermerët vendas" e Librit tuaj të Blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve nga fermerët e pajegjistruar për TVSH dhe paraqitni rezultatin në kutinë totale i vlerës së tatueshme në fund të faqes së këtij libri. Njëkohësisht shumën e përfutur vendosni në kutinë 18 të Deklaratës tuaj.

19. Nga kolona "TVSH i zbritshëm, kompensimi i fermerëve" e Librit tuaj të Blerjeve, mbliidni totalin e këtyre blerjeve dhe paraqitni rezultatin në fund të faqes së këtij libri. Shumën e përfutur vendosni në kutinë 19 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 19 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së kutisë 18 dhe përfitohet zbritja nga TVSH.

Saktësimet

20. Nqs në Deklaratën tuaj të muajit të kaluar keni një tepriçë TVSH të zbritshëm, paraqitni atë në kutinë 20. Kjo shumë është treguar në kutinë 24 të Deklaratës tuaj të muajit të kaluar.

21. Nqs vlera e paraqitur në kutinë 20 është mbi 400000 lekë dhe për cdo deklarate tuaj keni mbartur për 3 muaj të njëpasnjëshme TVSH të zbritshëm (vlera e treguar në kutinë 24, mbartur në kutinë 20 për 3 periudha të njëpasnjëshme) ju mund të paraqesni një kërkesë për Rimbursim të Tepriçës së TVSH të zbritshme. Plotësoni Formularin e Kërkesës për Rimbursim me shumën që ju duhet të rimbursoheni. Paraqitni këtë vlerë në kutinë 21 të Deklaratës tuaj.

22. Llogarisni gjendjen e TVSH së zbritshme nga muaji i kaluar duke zbritur nga vlera e kutisë 20, vlerën e kutisë 21 dhe rezultatin paraqitni në kutinë 22.

Totali i TVSH të zbritshëm për Muajin.

23. Llogarisni totalin e TVSH së zbritshëm për muajin, duke mbledhur TVSH e zbritshëm për Importet (kutia 15), TVSH e zbritshëm për Blerjet nga furnizuesit vendas (kutia 17), tvsh (kompensimi) i paguar për blerjet nga fermerët (kutia 19) dhe gjendjen e TVSH të zbritshëm nga muaji i kaluar (kutia 22). Shumën paraqitni në kutinë 23.

Tepriça e TVSH të zbritshëm.

24. Nqs Totali i TVSH të zbritshëm për muajin (kutia 23) është më i madh se TVSH i llogaritur për shitjet e muajit (kutia 12), keni një Tepriçë TVSH të zbritshëm dhe nuk duhet të bëni asnjë pagesë në këtë muaj. Llogaritni tepriçën e tvsh të zbritshëm duke zbritur vlerën e kutisë 12 nga vlera e kutisë 23 dhe paraqitni rezultatin e përfutur në kutinë 24. Nqs vlera e kutisë 12 është më e madhe ose e barabartë me vlerën e kutisë 23 shkruani zero në kutinë 24.

TVSH i detyrueshëm për tu paguar

25. Nqs TVSH i llogaritur për muajin (kutia 12) është më i madh se Totali i TVSH të zbritshëm për muajin (kutia 23), keni tvsh të detyrueshëm për tu paguar. Llogarisni TVSH e detyrueshëm për tu paguar duke zbritur vlerën e kutisë 23 nga vlera e kutisë 12 dhe paraqitni rezultatin e përfutur në kutinë 25. Nqs vlera e kutisë 23 është më e madhe ose e barabartë me vlerën e kutisë 12, shkruani zero në kutinë 25.